



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian

Mbledhja nr. 28

Prishtinë: Dt. 27.04.2022, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Arbëreshë Kryeziu Hyseni, Fridon Lala, Agon Batusha, Fjolla Ujkani, Shqipe Isufi, Driton Hyseni dhe Time Kadriaj.

Munguan: Rrezarta Krasniqi, Elmi Reçica, Blerta Deliu dhe Branisllav Nikoliq.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

E ftuar: znj. Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë.

Pjesëmarrësit tjerë: nga shoqëria civile: GLPS, KDI,NDI, asistentë nga grupet parlamentare, LVV, LDK dhe PDK.

Mbledhjen e kryesoi **Arbëreshë Kryeziu Hyseni**, nënkryetare e Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 1.4.2022 dhe 7.4.2022;
3. Raportim i znj. Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë;

4. Shqyrtimi i raportit plotësues lidhur me Projektligjin nr.08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-113 për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-070 për pijet e forta alkoolike, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Pasi që ministrja ende nuk kishte mbërri në Komision, kryesuesja propozoi që të bëhet ndërrimi i pikave të rendit të ditës, të procedohet me pika tjera, derisa të vijë ministrja.

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 1.4.2022 dhe 7.4.2022

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit plotësues lidhur me Projektligjin nr.08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Arbëreshë Kryeziu Hyseni, nënkryetare, njoftoi se më datë 21.12.2021 kemi shqyrtuar raportin me amendamente të Komisionit funksional, lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës, ndërsa sot kemi një raport plotësues që ndërlidhet me disa amendamente po për këtë projektligj. Pas shqyrtimit të këtij raport plotësues, konstatoi se këto amendamente të Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim të mëtejshëm.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti plotësues lidhur me Projektligjin nr.08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës me konstatimin se nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim të mëtejshëm.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-113 për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja, lidhur me këtë projektligj, tha se pas shqyrtimit të këtij projektligji dhe amendamenteve të Komisionit funksional, mund të konstatojmë se ky projektligj dhe amendamentet nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacion të BE-së dhe mund të rekomandohen për miratim të mëtejshëm.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.08/L-113 për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacion të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim të mëtejshëm.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-070 për pijet e forta alkoolike, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Arbëreshë Kryeziu Hyseni, nënkryetare, theksoi se pas shqyrtimit të këtij projektligji dhe amendamenteve të Komisionit funksional, mund të konstatojmë se ky projektligj dhe amendamentet e Komisionit funksional janë pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohen për miratim të mëtejshëm.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim.

Pas votimit, kryesuesja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.08/L-070 për pijet e forta alkoolike, me amendamentet e Komisionit funksional, janë pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohen për miratim të mëtejshëm.

6. Raportim i znj. Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë

Arbëreshë Kryeziu Hyseni, nënkryetare, falënderoi ministren për pjesëmarrje dhe tha ju kemi ftuar sot në këtë mbledhje që të diskutojmë lidhur me përmbushjen e obligimeve, të cilat i keni në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe përmbushjen e reformave në këtë drejtim.

Siç e dini, në seancën paraprake, ne kemi miratuar Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për vitin 2022-2026, program në të cilin janë paraparë prioritet dhe masa lidhur me përmbushjen e reformave dhe obligimeve të institucioneve tona në procesin e integritetit. Në kuadër të këtij programi, po ashtu janë paraparë prioritet edhe nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, prandaj ju kemi ftuar sot që të na raportoni edhe lidhur me planet dhe veprimet të cilat ju si Ministri i keni paraparë dhe ndërmarrë, me qëllim të përmbushjes së këtyre obligimeve që i keni paraparë.

Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, raportoi lidhur me zhvillimet e fundit në adresimin e reformave në fushën e drejtësisë, si dhe lidhur me përmbushjen e veprimeve të Ministrisë së Drejtësisë nga Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) dhe nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Fillimisht, theksoi se MD, në kuadër të kompetencave të saj, është e angazhuar seriozisht lidhur me avancimin e reformave në sektorin e drejtësisë, me theks të veçantë në përmirësimin e legjislacionit penal, kundër korrupsionit dhe atë të reformave gjyqësore, në kuadër të sfidave të dala nga Agjenda Evropiane në Republikën e Kosovës.

Qeveria ka miratuar Strategjinë për Sundimin e Ligjit, më datën 11 gusht 2021, që synon të promovojë integritetin, llogaridhënien dhe besueshmërinë në sistemin e drejtësisë. Kjo strategji ka vendosur objektiva dhe veprime specifike, për të rritur luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për të përmirësuar qasjen në drejtësi. Në bashkëveprim me drejtuesit e institucioneve të pavarura, KGJK, KPK dhe institucionet tjera, kemi mbajtur takimin e parë të Komitetit Drejtues, dhe tani jemi duke i adresuar aktivitetet që dalin nga implementimi i kësaj strategjie.

Sa i përket zhvillimeve të fundit në sektorin e drejtësisë, siç jeni të informuar, MD ka filluar punën në një ndër proceset më të rëndësishme në këtë sektor e që është zhvillimi i procesit të Vettingut. Në vazhdim, paraqiti veprimet e ndërmarra që nga marrja e mandatit si ministre, e cila tha se është miratuar koncept-dokumenti për Vettingun dhe kemi arritur të bëjmë draftin e amendamenteve kushtetuese dhe projektligjin për sistemin e drejtësisë.

Kemi qen të interesuar që ky premtim para qytetarëve të realizohet në përputhje me praktikat më të mira evropiane dhe në këtë drejtim i jemi drejtuar Komisionit të Venecias, për të marrë opinionin e tyre në raport me këtë çështje dhe rrjedhimisht delegacioni i Komisionit të Venecias nga data 17-18 dhe 19 maj, do të jenë në Kosovë, ku do të takohen me institucionet e Kosovës, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit tjerë, për të cilët ata kanë interes dhe pastaj në qershor të votohet opinionin për Vettingun në sistemin e drejtësisë. Kemi themeluar grupin punues për hartimin e Projektligjit për legjislacionin për procesin e Vettingut në sistemin e drejtësisë, në përbërje të cilit janë përfaqësuesit nga institucionet e drejtësisë: Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, institucionet tjera, organizatat e shoqërive civile dhe ekspertë të pavarur.

Një nismë tjetër e MD-së është edhe hartimi i projektligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme.

Projektligji është miratuar nga Qeveria dhe tani është në procedurat e shqyrtimit në Kuvend, është parë që rregullimi i tanishëm ligjor nuk ka treguar apo nuk është dëshmuar si i suksesshëm në

luftimin e pasurimit të paligjshëm, pasi që aktualisht me legjislacionin në fuqi, në çdo rast, kushtëzohet konfiskimi i pasurisë së përfituar përmes aktivitetit kriminal me zhvillimin e procedurës penale, që ndërlidhet me kryerjen e një vepre penale, gjë që paraqet pengesë juridike që krimi i organizuar të luftohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Përkundër faktit që ne e kemi sjellë në Kuvendin e Kosovës, por siç e dini opozita pati kërkuar që të dërgohet në Komision të Venecias dhe delegacioni i Venecias, në raport me këtë projektligj, do të vijë në Kosovë më 11 maj për të krijuar një opinion të saktë për këtë çështje.

Proces tjetër i rëndësishëm, i cili ka filluar në MD është themelimi i mekanizmit për dokumentimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Në këtë çështje jemi duke punuar në hartimin e projektligjit, për të cilin kemi themeluar grupin punues, i cili është duke hartuar draftin, qëllimi i të cilit është dokumentimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut, në të kaluarën, i cili do të ndihmojë në krijimin e kujtesës kolektive, në ndjekjen penale të autorëve të krimit dhe në identifikimin e viktimave. Është e rëndësishme se ne për herë të parë po krijojmë një institucion, ku do të dokumentohen krimet e kryera në luftën e fundit në Kosovë.

Sa i përket Projekt Kodit të rishikuar të Procedurës Penale, që ka të bëjë me eliminimin e pengesave ligjore dhe mundësimin e hetimit, por edhe gjyqimit në mungesë të kriminelëve të cilët kanë kryer krime lufte në Kosovë presim që të procedohet në Kuvend për lexim të dytë, sepse janë përfshirë dispozita të cilat janë pjesë e Agjendës Evropiane e që kanë të bëjnë me pezullimin ose largimin e zyrtarëve publikë të akuzuar për vepra të lidhura me korrupsionin.

MD, në kuadër të Reformës së Administratës Publike, që ndërlidhet edhe me ERA, i ka përfshirë në dispozitat përkatëse në dy kodet: Kodin Penal dhe Projekt-Kodin e Procedurës Penale. Në Kodin Penal parashihet ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike, personit zyrtar, i cili kryen vepra penale të korrupsionit apo keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Për Projekt- Kodin e Procedurës Penale, MD ka kërkuar opinion nga Komisioni i Venecias, i cili Komision ka ofruar opinionin e tij që në parim është në frymën e këtij Projekt-Kodi.

Për parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje, kemi hartuar politikat kundër dhunës në baza gjinore, si dhe gjithashtu do të funksionalizojmë mekanizmat për trajtimin e kësaj çështje. Për këtë qëllim, MD do të angazhohet në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Është miratuar Strategjia kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, në janar të këtij viti dhe jemi munduar që ta bëjmë në një linjë me Konventën e Stambollit.

Së fundi, kemi dërguar në Kuvend edhe një paketë ligjore me 3 projektligje e që janë: Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, Projektligji për shërbimin korrektues dhe Projektligji për shërbimin sprovues. Jemi duke i rinovuar të gjitha objektet që ne konsiderojmë që duhet dhe tani jemi duke e rinovuar një pavijon ku do trajtohen personat që janë të burgosur, por që kanë probleme të ndryshme mendore dhe që duhen trajnime speciale.

MD, në kuadër të avancimit të reformës në drejtësi, ka sponsorizuar projektligjin për Gjykatën Komerciale, i cili është miratuar dhe shumë shpejtë do të funksionalizohet, sepse është i rëndësishëm në kuptim të zhvillimit ekonomik të vendit.

Projektligji për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, është miratuar në Qeveri dhe është proceduar në Kuvend.

Sa i përket fushës së kundër korrupsionit, MD ka proceduar Projektligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Projektligjin për deklarimin, origjinën dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve publikë, këto projektligje janë duke u shqyrtuar nga Kuvendi. Vlen të përmendet që kur jemi te lufta kundër korrupsionit, Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe Qeveria e Kosovës ka miratuar Udhëzimin Administrativ për përcaktimin dhe procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, e cila ka për qëllim adresimin dhe mbrojtjen e zyrtarëve që raportojnë shkeljet përbrenda institucioneve. Si ministre e Drejtësisë nuk jam e kënaqur me nivelin e zbatimit të këtij ligji. Ne në Qeveri kemi votuar Rregulloren që zbatimi i tij të jetë më i lehtë dhe jam në kontakt me drejtorin e Agjencisë, që të shohim fushata sensibilizuese, që zyrtarët publikë të njoftohen për ligjin në fuqi dhe t'i adresojnë shkeljet brenda institucioneve që u takojnë.

Është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar. Është hartuar drafti i koncept-dokumentit për Fondin e Konfiskimit, qëllimi i të cilit është të mundësohet krijimi i infrastrukturës së përgjithshme ligjore për përdorimin e pasurive të konfiskuara nëpërmes themelimit të një fondi të konfiskimit nga institucionet që merren me zbatimin e ligjit dhe ri-përdorimit social, tani ky koncept-dokument është proceduar në Qeveri për shqyrtim dhe miratim.

Po ashtu janë miratuar nga Qeveria edhe Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe Projektligji për kompensimin e viktimave të krimit, që janë proceduar për shqyrtim në Kuvend.

Në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar janë miratuar nga Qeveria dhe janë në faza të ndryshme të shqyrtimit në Kuvend, Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile (miratuar nga Kuvendi), Projektligji për plotësim dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale (miratuar nga Kuvendi), Projektligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private, Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështje Civile dhe Tregtare.

Në fushën e profesioneve të lira ligjore kemi proceduar Projektligji për provimin e jurisprudencës, i cili ka kaluar leximin e parë. Janë miratuar nga MD Udhëzimi administrativ për tarifën e ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës dhe për përcaktimin e procedurës së ndërmjetësimit të rasteve dhe rasteve të referuara nga organi administrativ. Kemi adresuar edhe udhëzimin administrativ për uljen e tarifave të përmbauesve privatë dhe kjo është pritur mirë nga ana e

qytetarëve, sepse është konstatuar se janë më të larta se në vendet e rajonit, kurse shërbimet e noterisë nuk janë më të larta se në vendet e rajonit.

Në bashkëveprim me Zyrën përkatëse të Kryeministrit për Integrim Evropian, janë përcaktuar indikatorët e PKZMSA-së, për vitin 2022, nga të cilat ne i kemi 12 masa, prej tyre 5 janë përmbushur në fillim të këtij viti dhe të tjerat janë në proces të përmbushjes, të cilat janë duke u trajtuar me përkushtim dhe prioritet të lartë për përfundimin e tyre sipas afateve të parapara.

Si ministre e Drejtësisë, shpreh optimizmin tim, përkitazi me iniciativat e ndërmarra në drejtim të ngritjes dhe forcimit të rendit juridik në Republikën e Kosovës.

Driton Hyseni e përgëzoi ministren për punën e madhe, i cili tha se po e bëni sidomos në plotësimin dhe implementimin e kriterëve që duhet t'i përmbushni si ministri në përparimin drejt integritimit në BE. E potencuat strategjinë për sundimin e ligjit, e cila është miratuar në Qeveri, vitin e kaluar, si ministre a jeni e kënaqur me progresin e bërë në implementimit të kësaj strategjie dhe në bashkëpunimin mes institucioneve që janë në sektorin e gjyqësorit dhe prokurorisë? Si e shihni bashkëpunimin e Ministrisë me Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor në implementimin e Strategjisë për sundimin e ligjit?

Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, tha se Strategjia për sundimin e ligjit është një dokument shumë i rëndësishëm për çka deri më tani nuk kam parë vullnetin e plotë të krerëve të institucioneve të drejtësisë për zbatimin e kësaj strategjie. Po ashtu kemi pasur me ta një takim të përbashkët të iniciuar nga presidentja Osmani dhe në Samitin për demokraci, të thirrur nga presidenti i SHBA z. Bajden, presidentja Osmani ka ngritur çështjen që lidhet edhe me reformën në drejtësi dhe një prej pikave që ka të bëjë edhe me Strategjinë për sundimin e ligjit. Pas përfundimit, jemi zotuar njëzëri se do t'i zbatojmë obligimet që i kemi në dokumentet tona që i kemi votuar si institucione. Deri më tani nuk kam parë një mungesë të vullnetit nga krerët e institucioneve në drejtim të implementimit të kësaj strategjie, dilemën e kanë te çështja e Vettingut në sistemin e drejtësisë. Në këtë drejtim, ne konsiderojmë se i vetmi çelës në duar për ta bërë Kosovën shtet të së drejtës është çështja e Vettingut dhe çështja e përbërjes së Këshillit Prokurorial dhe ne konsiderojmë që numri duhet të ulet nga 13 në 7 anëtarë, prandaj ne jemi të obliguar që të punojmë në përputhje me programin qeverisës, mirëpo specifikisht në kuptim të strategjisë për sundimin e ligjit, ata janë në linjë me MD-në dhe kam parë vullnetin për zbatim të saj.

Driton Hyseni, tha se situata me pandeminë ka ndikuar në grumbullimin e lëndëve në gjyqësor dhe me kuadrin e ri që po plotësohet me dhënien e provimit të jurispondencës, a po arrihet të përmbushet numri i kuadrove që mund të përshpejtojë procedimin e këtyre lëndëve dhe zgjidhjen e çështjeve gjyqësore? Po ashtu e përmendet dokumentimin e krimeve që Serbia ka bërë gjatë luftës në Kosovë, nuk e di sa ka mundësi që kjo të përfshijë edhe një periudhë pak më të gjerë, sepse krimet e Serbisë nuk kanë ndodhur vetëm gjatë luftës, por edhe më herët.

Sa i përket marrëveshjes me Danimarkën, desha një konstatim tuaj, a i konsideroni benefite të tilla të cilat përfitohen nga kjo marrëveshje që tregojnë për një partneritet të mirë të Kosovës me partnerët ndërkombëtarë dhe një besueshmëri të shteteve respektive në drejtim të afirmimit të mëturshëm të relacioneve me Kosovën dhe besimin në institucionet tona?

Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, tha se sa i përket pyetjes që lidhet me shtimin e kapaciteteve, sidomos për gjykatat, ju inkurajoj që t'i thërrisni në raportim kryesuesin e Këshillit Prokurorial dhe kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për faktin se ata janë duke bërë planifikimet për rekrutimin e stafit të ri për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe bashkëpunëtorë profesionalë, që do t'i ndihmojnë drejtësisë, që mos të ketë më zvarritje të lëndëve.

Kurse, lidhur me çështjen që lidhet me krimet e luftës dhe dokumentimit të krimeve, ju njoftoj se instituti nuk do të kufizohet vetëm me krimet e kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, mirëpo pas përfundimit të dokumentimit të krimeve gjatë periudhës së luftës, pastaj mandati i tij do të lëshohet edhe për periudhën para luftës, sepse pajtohem me ju, kanë ndodhur krime edhe viteve të paraluftës.

Sa i përket marrëveshjes me Danimarkën, është marrëveshje që e kam trashëguar kur kam marr mandatin e ministres, kam pasur komunikime me ministrin e Drejtësisë së Danimarkës dhe jam njoftuar që nuk kanë kapacitete në burgjet e tyre dhe nuk kanë staf për rekrutim dhe përkundër faktit që hapin konkurse, askush nuk paraqitet për oficer korrektues. Ne jemi pajtuar që ta vazhdojmë një punë që unë e kisha gjetur në Ministrinë e Drejtësisë dhe çuditërisht me qeverinë e kaluar, që gjoja nuk kanë qenë të informuar në raport me këtë. Një marrëveshje e tillë e fuqizon bashkëpunimin dhe kemi marrë zotimin nga Danimarka, që do të na ndihmojnë në secilën pengesë që ne i kemi si shtet në anëtarësimin në mekanizmat ndërkombëtarë.

Fjolla Ujkani kishte një pyetje, që lidhet direkt me fushën e legjislacionit evropian. Ajo tha se duke u bazuar në parimin e subsidiaritetit, ku vendet e BE-së nuk përmbushin obligimet e tyre që kanë karshi BE-së, dhe duke pasur parasysh që ne nuk jemi pjesë e BE-së, a ka pasur raste të tilla më herët që vendimet e marra nuk kanë qenë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe si kanë vepruar nga ana e BE-së, karshi nesh, edhe pse nuk jemi pjesë e BE-së dhe me cilin mekanizëm kanë vepruar karshi nesh dhe si ka qenë përgjigjja nga institucioni që e drejtoni ju, edhe pse gjatë mandatit tuaj nuk kam dëgjuar se ka pasur raste të tilla, por vetëm dua të dijë, si kanë vepruar më herët?

Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, tha se secila ministri kur përgatit dokumentet për procedim në Kuvend të Kosovës, së pari duhet ta ketë deklaratën financiare dhe deklaratën se është në përputhje me *acquis communautaire*. Unë nuk kam bërë një vlerësim sesi kanë vepruar qeveritë e kaluara, por mund ta bëjë një gjë të tillë, nëse është në interes të komisionit, por në përgjithësi ka pasur raste që dokumentet e tilla nuk kanë qenë në linjë në një masë me standardet evropiane dhe megjithatë konsideroj se edhe Kuvendi i Kosovës këtu ka pasur një rol, duke pasur parasysh Komisionin për Integritet Evropian, ku secili dokument kalon në këtë komision, për te vlerësuar

se i njëjti është në përputhje me legjislacionin e BE-së .Në mandatin tim nuk është asnjë dokument i vetëm që nuk është në përputhje me legjislacionin e BE-së, pavarësisht që nuk jemi anëtar të BE-së, është mirë që dokumentet tona sa më parë të harmonizohen me legjislacionin e BE-së.

Agon Batusha, theksoi se në raportin për vendin në vitin e kaluar, është përmendur moszbatimi i duhur i kornizës ligjore në aspektin e pastrimit të parave. A ka ndërmarrë ministria ndonjë hap në këtë drejtim dhe a mund të presim ndonjë hap pozitiv nga gjykata dhe prokuroria?

E dimë që kushtet janë të mira për anëtarësim në Këshillin e Evropës, dhe nëse anëtarësohemi, bëhemi edhe pjesë e Gjykatës së Strasburgut, që ka të bëjë me te drejtat e njeriut. Andaj, në çfarë faze të përgatitjes jemi dhe sa ndikon tek e drejta e qytetarëve për t'iu drejtuar Gjykatës së Strasburgut. Ne kemi parë në raportet për vendin dhe në komunikim me zyrtarët e BE-së janë disa raste të targetuara dhe raste që mbikëqyren në gjykata sesi ne marrim vendime për ato raste ku janë të përfshirë zyrtarët politikë, kemi parë rastet si pronto dhe afera e pasaportave, ku në fund të gjithë dolën të pafajshëm. Sa ndikon kjo në procesin tonë drejt BE-së, ku janë të targetuara rastet e korrupsionit të zyrtarëve të lartë? U përmend liberalizimi i vizave dhe natyrisht ndërlidhen të gjitha këto që u thanë më lart. A keni pasur ndonjë rast nga ndonjë shtet skeptik që kanë kërkuar kritere shtesë që Kosova t'i plotësojë në aspektin e drejtësisë?

Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, tha se lidhur me pyetjen në raport me shpëlarjen e parave, siç jeni në dijeni, Prokuroria Speciale e ka një departament që merret me raste të tilla, mirëpo ne jemi duke e shikuar mundësinë që t'i shtojmë kapacitetet, sepse dy prej departamenteve që unë konsideroj se kanë nevojë për shtim të kapaciteteve dhe që konsideroj se nuk është bërë puna siç duhet është Departamenti për Luftimin e Krimit dhe Korrupsionit, ku hyjnë kompetencat e Prokurorisë Speciale, në aspektin e shpëlarjes së parave dhe Departamenti për Krime të Luftës. Pra, dy departamentet që janë më të rëndësishmet nuk është bërë aq sa duhet në këtë drejtim.

Prandaj, me fuqizimin e njësitit të inteligjencës financiare, që është në kuadër të Ministrisë së Financave dhe me fuqizimin e kapaciteteve në kuadër të Prokurorisë Speciale dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, konsideroj se situata do të jetë më optimiste. Në raport me Këshillin e Evropës, jam e bindur që është duke u bërë një punë e mirë në këtë drejtim dhe kjo për qytetarët tanë është shumë e rëndësishme për faktin që të drejtat e tyre që janë të njohura me Kushtetutën e Kosovës, po ashtu edhe me konventat ndërkombëtare dhe këtu krahas përpjekjeve tona për anëtarësim në Këshillin e Evropës duhet t'i shtojmë kapacitetet në institucionet tona, sepse pastaj ju e dini me çka do të përballen institucionet e drejtësisë, në rast se qytetarët tanë pastaj i drejtohen mekanizmave të tjerë, prandaj krahas anëtarësimit duhet të adresojmë fuqizimin e kapaciteteve në institucionet e drejtësisë, që mos të zvarriten lëndët me vite të tëra.

Sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën nuk dha ndonjë afat kohor, por tha se do të vazhdojnë dialogun me Francën dhe vendet skeptike për t'i bindur se meritojnë një gjë të tillë.

Pas zgjedhjeve në Francë, besoj që do të vazhdojë dialogu për t'i bindur ata për të drejtën e qytetarëve tanë për të lëvizur lirshëm. Jam e njoftuar me angazhimin e Qeverisë së Kosovës me shtetet skeptike në këtë drejtim dhe natyrisht presim për liberalizim të vizave për qytetarët tanë.

Unë nuk mund të flas me data, siç kanë folur qeveritë e kaluara dhe nuk do të ishte korrekte të thirremi në data, por ajo çka ne iu kemi garantuar shteteve është vullneti i hekurt që ka Qeveria Kurti për adresimin e luftës kundër krimit dhe korrupsionit dhe ne jemi duke punuar së pari që t'i adresojmë shkeljet që edhe i kemi gjetur.

Kurse, rastet që janë në kuadër të Prokurorisë Speciale e që janë rastet e profilit të lartë dhe që kanë vëmendje edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, se po flitet për rastet ku korrupsioni ka qenë jashtëzakonisht i madh dhe duhet të shpreh zhgënjimin tim për rastet që kanë vëmendjen publike dhe të cilat po dështojnë pranë institucioneve të drejtësisë, për shkak të parashkrimit të tyre dhe të gjitha rastet e parashkrimeve duhet të vlerësohen nëse ka qenë një parashkrim i qëllimshëm, sepse si ka mundësi që për një zyrtar të lartë të parashtrohet lënda e korrupsionit, kurse për një qytetar që nuk ka ndonjë pozitë të lartë po janë shumë efikas.

Pse nuk po mundën me qenë efikas edhe te rastet e krimit të organizuar dhe të korrupsionit, si rasti toka, rasti i veteranëve, rasti pronto etj.

Konsideroj se nuk e kanë pasur vëmendjen dhe vullnetin e duhur institucionet e drejtësisë që t'i adresojnë siç duhet rastet. Pra, ne jemi duke u munduar që përmes procesit të Vettingut, të kemi prokurorë dhe gjyqtarë të guximshëm, me integritet moral dhe profesional, të cilëve u intereson vetëm Kushtetuta, ligji dhe lënda që e ka para vetes dhe që nuk ndikohet nga askush.

Në Qeverinë tonë nuk do të ketë rrethana ku një gjyqtar apo prokuror kërcënohet apo iu bëhet presion për lëndën që po e trajton. Andaj, unë nuk kam besim që pa procesin e Vettingut, që do të fillojë nga nivelet e larta, do të kemi veprime serioze sidomos në raport me raste të krimit të organizuar dhe korrupsionit, andaj jemi duke e bërë një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë.

Shqipe Isufi, tha se do të ndalem pak te Raporti i Progresit për vendin, zakonisht tek të gjeturat ndër vite janë dhuna në familje, raportimi i rasteve, trajtimi i viktimave mbetet një sfidë në vete.

Ne të gjithë jemi në dijeni me hapat që i kemi ndërmarrë me formimin e Strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje. A mendoni se ka filluar të ndjehen rezultatet në raportimin e rasteve dhe trajtimi i viktimave, a është rritur besueshmëria në seriozitetin dhe përkushtimin institucional në vendin tonë? Kurse, për hir të opinionit publik kisha dashur të na njoftoni se në cilën fazë gjendeni në procesin e Vettingut?

Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, tha se një prej prioriteteve të MD-së është po ashtu adresimi i dhunës në familje, si fenomen jashtëzakonisht i rrezikshëm që po e cenon jetën e grave dhe vajzave tona. Në këtë drejtim, ne i kemi kryer obligimet tona, sa i përket hartimit të dokumenteve që janë në mandat të Ministrisë së Drejtësisë. Pra, menjëherë, sapo kemi marrë detyrën kemi vendosur koordinatorin nacional kundër dhunës në familje dhe për herë të parë kemi aktualizuar grupin ndërministror, ku ka takime të rregullta dhe janë të përfshirë përfaqësues të institucioneve që kanë mandat në adresimin e rasteve të dhunës në familje, kemi hartuar Strategjinë për mbrojtjen kundër dhunës në familje dhe ju kemi mundësuar që viktimat e dhunës në familje të mbrohen nga shteti me mbrojtje juridike falas. Konsideroj se ekzistojnë dy probleme, sepse ende në institucionet e drejtësisë dhe sigurisë ka ende një paragjykim dhe një neglizhencë të rasteve të

dhunës në familje, sepse tentohet të fajësohet e mbijetuara, e cila raporton dhunën dhe nuk merren seriozisht me këtë raportim. Unë, në çdo takim që kam pasur, qoftë me policinë, me prokurorinë dhe gjykatat, kam kërkuar që ky fenomen ta ketë vëmendjen, sepse nga veprimi apo mosveprimi i tyre kemi raste që kanë përfunduar me fatalitet dhe konsideroj se pa një vëmendje serioze në këtë drejtim dhe pa marrjen e masave ndaj atyre që nuk i kryejnë detyrat, situata nuk mund të përmirësohet, edhe pse së fundi ka një vëmendje pak më të madhe, por nuk është e mjaftueshme, konsideroj se duhet edhe Kuvendi, shoqëria civile dhe të gjitha institucionet, të bëhemi bashkë kundër dhunuesve dhe t'i thërrasim në përgjegjësi, në raport me këto raste. Dhuna në familje nuk është çështje private, është obligim institucional dhe obligohen institucionet e thirrura ta kryejnë detyrën e tyre.

Driton Hyseni, pyeti ministren: A ka shumë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve në sistem dhe a janë duke u publikuar ato konform ligjit? Gjithashtu, sa i takon MSA-së, keni paraparë që në fund të vitit të keni dy marrëveshje bashkëpunimi juridik me Francën dhe Zvicrën, duke pasur parasysh se kemi shumë bashkatdhetarë atje e sidomos në Zvicër, sa këto marrëveshje do të jenë në shërbim të tyre dhe a do të eliminojnë shumë prej çështjeve që ata mund të ballafaqohen sa i përket aspektit juridik?

Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, tha se në raport me masat disiplinore që merren për gjyqtarët nuk jam e kënaqur me masat të cilat po merren dhe kjo është përgjegjësi e KP dhe KGJ dhe mund të kërkon nga ta që t'ju dërgojnë raport me shkrim për këto masa dhe mund të vlerësoj se KGJ qëndron pak më mirë se KP i Kosovës, kurse sa i përket marrëveshjes për bashkëpunim juridik me Zvicrën e kemi nënshkruar, kurse me Francën, për shkak të zgjedhjeve atje, negociatat janë shtyrë për shtator.

Arbëreshë Kryeziu Hyseni, nënkryetare, falënderoi ministren për gatishmërinë për të qenë në komision, sa herë që thirret dhe për bashkëpunimin dhe seriozitetin që tregon kabineti i saj.

Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë shprehu keqardhje që opozita nuk ishte gjatë raportimit të saj në komision dhe tha se i vjen shumë keq që opozita nuk e shfrytëzoi një mekanizëm që është i rëndësishëm, siç është mbikëqyrja parlamentare, sepse përmes këtij mekanizmi, ata kërkojnë llogari për veprimet tona.

7. Të ndryshme

Arbëreshë Kryeziu Hyseni, nënkryetare, tha se para se t'ua jap fjalën anëtarëve, nëse kanë për të shtuar lidhur me këtë pikë, dua të diskutoj lidhur me mosprezencën e anëtarëve të opozitës në Komision, sepse ne e pamë që me të filluar kjo mbledhje, një anëtarë e opozitës hyri u nënshkrua dhe doli. Kjo është një çështje që duhet ta diskutojmë, sepse konsideroj se duhet t'i japim fund nënshkrimeve sa për mëditje, nëse opozita ka vendosur ta bojkotojë punën në Kuvend, atëherë le

ta bëjnë zemrën gur dhe ta bojkotojnë edhe mëditjen, sepse nuk duhet t'i ikin përgjegjësisë, duke pasur parasysh që jemi Komision funksional, ka nga anëtarët që janë pjesë edhe e komisioneve tjera, megjithatë arrijmë ta aranzhojmë këtë dhe t'ë paktën e njoftojmë komisionin se duhet ta lëmë këtë mbledhje e nuk na ndodh neve ta lëshojmë mbledhjen, siç e lëshoi deputetja e opozitës. Publikisht, dua të kërkoj nga administrata që të na sjellin një fletë të re të nënshkrimeve dhe shpresoj se opozita do të vetëdijesohet me këtë veprim, që po e bëjnë në vazhdimësi, jo vetëm nëpër komisione, por edhe nëpër seanca, vijnë nënshkruhen sa për mëditje dhe dalin.

Mbledhja përfundoi në orën 14:05.

Arbëreshë Kryeziu Hyseni,

Zëvendëskryetare e Komisionit

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit